

**TRYEZË SHKENCORE: KULTURA E GJUHËS NË MEDIET
TONA - ARRITJE DHE PROBLEME AKTUALE**

Shoqata e Gjuhës Shqipe e Kosovës në datat 7-8 qershor 2013 organizoi në Prishtinë tryezën shkencore me titull “*Kultura e gjuhës në mediet tona - Arritje dhe probleme aktuale*”. Këshilli organizues përbëhej nga Z. Isa Bajçinca, Znj. Shefkije Islamaj, Z. Sulejman Dërmaku, Z. Ragip Mulaku dhe Z. Qemal Murati.

Studiuesi Isa Bajçinca mbajti fjalën e rastit dhe vijoi me kumtesën me titull “*Pasqyra e gjuhës në mediet tona - pasqyrë e kulturë së përgjithshme*”. Kjo kumtesë ishte pjesë e programit të seancës së parë, që u drejtua nga Z. Isa Bajçinca, Znj. Shefkije Islamaj dhe Z. Hamit Boriçi. Sipas rendit, në seancën e parë në vijim kumtuam:

Shefkije Islamaj: *Çështje stili në mediet tona*

Hamit Boriçi, Jolanda Lila: *Tipare problemore të gjuhës së gazetave shqiptare*

Rami Memushaj: *Norma semantike dhe lajthitje semantike në mediet tona televizive*

Rozana Rushiti: *Probleme të nyjave dhe të disa përemrave në gjuhën e medias*

Qemal Murati: *Shqipja “Coctail” e medieve tona*

Shpresa Hoxha: *Gjuha shqipe në qendrat tona televizive*

Adelina Çerpja: *Apostrofi - (mos)përdorimi i tij sipas normës gjuhësore në media.*

Seanca e dytë u mbajt më datë 8 qershor dhe u drejtua nga Rami Memushaj, Adelina Çerpja dhe Qemal Murati. Kumtuam në vijim:

Ragip Mulaku: *Shmangie gjuhësore në shtypin tonë*

Anila Çepani: *Shmangie nga përdorimi i përemrave lidhorë në gjuhën e medias*

Hysen Matoshi: *Gjuha e debateve televizive*

Bahtijar Kryeziu: *Mediet, e tashmja dhe e ardhmja e shqipes*

Sulejman Dërmaku: *Shpërfillja e skajshme e kulturës së gjuhës në mediet tona*

Rafaela Marteta: *Veçori gjuhësore të ligjërimet gazetaresk në të përditshmet e shtypura.*

Shkumbin Munishi: *Përdorimi i shqipes në mediet audio-vizuale, çështje të përzgjedhjes së kodit të komunikimit.*

Nexhmije Kastrati: *Gjuha e moderatorëve, debatuesve dhe lexues(e)ve të shtypit të Tv-së*

Sheremet Krasniqi: *Ndikimi i gjuhës së administratës në medie dhe anasjelltas.*

Seanca e tretë dhe përmbyllëse u drejtua nga Anila Çepani, Ragip Mulaku dhe Sulejman Dërmaku.

Kumtesat paraqitën shumë-llojshmëri problematikash të nryjtuara si më poshtë:

Abdullah Zymberi: *Disa gabime në të folur nga udhëheqës të emisioneve në Klan Kosova*

Shpëtim Zeneli: *Natyra e gabimeve gjuhësore në portale sportive*

Afërdita Abdullahi: *Gjuha e shtypit*

Senad Neziri: *Kultura gjuhësore e medieve televizive në Prizren*

Shpresa Ismajli: *Gjuha shqipe në reklama (të medias!)*

Naim Berisha: *Kompjuteri dhe shqipja e internetit*

Fatmir Fejziu: *Gabime drejtshkrimore dhe shkarje gjuhësore në reklama dhe titra televizivë*

Bahri Koskoviku: *Shmangie nga norma sintaksore në gjuhën e medieve*

Sejdi M. Gashi: *Shqipja standard në debate televizive në Kosovë*

Abdurrahim Maxhuni: *Një vështrim mbi përdorimin e standardit nga mysafirë në emisione televizive.*

Gjovalin Shkurtaç, Alessia Bergamin (Shkurtaç): *Dukuri të varfërimit shprehës në emër të "modernitetit"*

Në fund të çdo seancë dhe në veçanti në fund të seancës përmbyllëse, tryeza u gjallërua nga diskutime rreth çështjeve të ngritura. Ndër të tjera veçojmë diskutimet për drejtshkrimin e termit media/ medie, term për të cilin studiuesit kishin mendime dhe qëndrime të ndryshme.

Në përmbyllje të tryezës shkencore, duke pasur parasysh punimet e seancave, studiuesit hartuan një promemorie drejtuar institucioneve mediatike në përgjithësi. Në këtë promemorie u bëhej ftesë drejtuesve të mediave, por edhe operatorëve të ndryshëm mediatikë, për më shumë përpjekje për të pasqyruar pozitivisht problematikat e ngritura në tryezë.

Fjala e mbylljes u mbajt nga studiuesi Isa Bajçinca, i cili kujtoi edhe njëherë dobinë e këtyre tryezave dhe falenderoi pjesëmarrësit për kontributin shkencor në këtë drejtim.

Adelina Çerpja